



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.70

16 qershor

2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.105, datë 4.6.2007	Për dhënie pëlqimi për emërimin e zotit Vladimir Kristo kryetar i Gjykatës Kushtetuese.....	1969
Vendim i Kuvendit nr.106, datë 4.6.2007	Për dhënie pëlqimi për emërimin e zotit Ardian Nuni anëtar i Gjykatës së Lartë.....	1969
Vendim i Kuvendit nr.107, datë 4.6.2007	Për emërimin e një anëtari të bordit të komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike.....	1970
Vendim i Kuvendit nr.108, datë 4.6.2007	Për miratimin e raportit për veprimtarinë vjetore të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit.....	1970
Rezolutë e Kuvendit datë 31.5.2007	Për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2006.....	1970
Rezolutë e Kuvendit datë 4.6.2007	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për vitin 2006.....	1971
Dekret nr.5339 datë 31.5.2007	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	1972
Dekret nr.5343 datë 6.6.2007	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	1973
Dekret nr.5350 datë 11.6.2007	Për krijimin e rretheve gjyqësore, caktimin e kompetencave tokësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre	1974
Dekret nr.5351 datë 11.6.2007	Për krijimin e seksioneve të veçanta penale për gjykimin e të miturve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore	1975

Vendim i KM nr.244, datë 7.3.2007	Për përcaktimin e numrit të punonjësve në ministritë dhe institucionet qendrore, për vitin 2007.....	1976
Vendim i KM nr.316, datë 30.5.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.244, datë 7.3.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve në ministritë dhe institucionet qendrore, për vitin 2007”	1978
Vendim i KM nr.326, datë 30.5.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë	1978
Vendim i KM nr.327, datë 6.6.2007	Për lejimin e daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për në Kinë, të 22 pikturave dhe të një ikone, objekte me vlera unikale, të trashëgimisë kulturore kombëtare, në datat 12-28 qershor	1980
Vendim i BSH nr.31, datë 6.6.2007	Për miratimin e rregullores “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”	1985
Vendim i ERE nr.34, datë 8.6.2007	Për dhënien e licencës për importin e energjisë elektrike “Spahiu Gjanc” sh.p.k.....	1994
Vendim i ERE nr.35, datë 8.6.2007	Për dhënien e licencës për eksportin e energjisë elektrike “Spahiu Gjanc” sh.p.k.	1995
	Shpallje kërkesë për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga rehabilitimi i rrëshqitjeve të ndodhura përgjatë segmentit rrugor Fier-Ura e Povelës.....	1995

VENDIM
Nr.105, datë 4.6.2007

**PËR DHËNIE PËLQIMI PËR EMËRIMIN E ZOTIT VLADIMIR KRISTO KRYETAR I
GJYKATËS KUSHTETUESE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 125 pika 4 të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 pika 6 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr.5329, datë 23.5.2007,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Vladimir Kristo Kryetar i Gjykatës Kushtetuese.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.106, datë 4.6.2007

**PËR DHËNIE PËLQIMI PËR EMËRIMIN E ZOTIT ARDIAN NUNI ANËTAR I GJYKATËS
SË LARTË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136 pika 1 të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 pika 6 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr.5252, datë 4.4.2007,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Ardian Nuni anëtar i Gjykatës së Lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.107, datë 4.6.2007

**PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ENTIT
RREGULLATOR TË SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Ekipit Përzgjedhës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Entela Shehaj (Fico) emërohet anëtare e Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike në vend të zotit Abaz Aliko, i cili ka dhënë dorëheqjen.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.108, datë 4.6.2007

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR VEPRIMTARINË VJETORE TË KËSHILLIT
KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 7 pika 19 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

I. Miratohet raporti i paraqitur nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit për veprimtarinë e këtij të fundit gjatë vitit 2006.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2006

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 28 pika 3 të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, pasi u njoh me Raportin për Veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2006 dhe me raportin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat për vlerësimin e veprimtarisë së këtij institucioni,

- duke njohur rolin e këtij institucioni për sigurimin e depozitave të shtetasve, të vendosura në institucionet bankare që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë dhe për kompensimin e tyre në rast të falimentimit të ndonjë institucioni bankar,

konstaton se:

- veprimtaria e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”.

Komisioni vlerëson pozitivisht veprimtarinë e këtij institucioni për:

- rritjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me Autoritetin Mbikëqyrës (Bankën e Shqipërisë), për kontrollin e saktësisë së primit të llogaritur nga institucionet bankare, të siguruara pranë këtij institucioni dhe për vlerësimin e gjendjes financiare të tyre, me qëllim rritjen e sigurisë së sistemit bankar;

- administrimin me efektivitet të mjeteve financiare dhe arritjen e rezultatit financiar pozitiv, duke zbatuar politikat e institucioni për investimin e fondeve në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare dhe në letra me vlerë në monedhë të huaj të qeverive, bankave qendrore dhe institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare.

Komisioni kërkon që për vitin 2007 Agjencia e Sigurimit të Depozitave të thellojë më tej përpjekjet në drejtim të:

- kryerjes së studimeve të plota dhe të thelluara për sfidat e skemave të sigurimeve të depozitave në procesin e integritetit të vendit;

- njohjes në kohë të direktivave europiane në fushën e sigurimit të depozitave;

- përmirësimit dhe plotësimit në kohë të kuadrit ligjor e nënligjor të veprimtarisë së

institucionit, në përputhje me ndryshimet e ndodhura në vend, bazuar edhe në përvojat më të mira ndërkombëtare dhe rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare;

- aplikimit të teknologjive bashkëkohore, që lehtësojnë manaxhimin e Agjencisë dhe sidomos përmbushjen e misionit të saj;

- shtimit dhe zgjerimit të veprimtarisë trajnuese të stafit të institucionit, me qëllim rritjen e profesionalizmit të tij.

31 maj 2007

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT PËR VITIN 2006

Pasi u njoh me Raportin Vjetor të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për vitin 2006, bazuar në nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit,

Kuvendi,

- duke njohur rolin e KKRT-së, si enti i vetëm rregullator në fushën e transmetimeve radio e televizive dhe autoriteti kryesor i zbatimit të legjislacionit shqiptar në këtë fushë;

- duke vlerësuar se veprimtaria e KKRT-së është në vazhdim të përpjekjeve të zbatimit të reformave institucionale për përshtatjen e saj me të gjitha funksionet ligjore në fushën e transmetimeve radio e televizive;

- duke qenë i ndërgjegjshëm se veprimtaria e KKRT-së është zhvilluar në kushtet e ekzistencës së shumë operatorëve në treg dhe të një situatë, ku zhvillimet teknologjike në fushën e transmetimeve radio e televizive kanë qenë të vrullshme;

- duke çmuar si jashtëzakonisht të rëndësishëm bashkëpunimin ndërinstitucional të KKRT-së me institucionet kombëtare dhe ato ndërkombëtare, si Këshilli i Europës, OSBE-ja etj.;

Konstaton se:

- KKRT-ja ka bërë hapa pozitivë në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;

- janë bërë hapa përpara në drejtim të rregullimit të veprimtarive të transmetimeve radio e televizive në Republikën e Shqipërisë;

- KKRT-ja, megjithëse e vonuar, ka ndërmarrë hapa në drejtim të zbatimit të kërkesave të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

- KKRT-ja nuk ka qenë në gjendje të ndalojë në kohë operatorët, të cilët kanë shkelur kushtet e parashikuara në licencat e tyre, lidhur me hapësirat e transmetimeve radio e televizive;

- KKRT-ja nuk ka zbatuar në mënyrë rigoroze dhe të padiferencuar kërkesat e ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

- KKRT-ja është gjetur e papërgatitur në hartimin në kohë të planit kombëtar të caktimit të frekuencave për transmetimet analoge tokësore dhe ato numerike, në përputhje edhe me parashikimet e Konferencës së Radiokomunikacioneve RRC-04 Gjenevë, maj 2004 dhe të Marrëveshjes së Gjenevës GE06.

Duke njohur rëndësinë e zhvillimit të mëtejshëm dhe të përmirësimit të legjislacionit në fushën e veprimtarive të transmetimeve radio e televizive, si dhe rolin përcaktues të KKRT-së në këtë fushë,

Kuvendi i kërkon KKRT-së:

- i tërheq vëmendjen KKRT-së në drejtim të rritjes së autoritetit të zbatimit të ligjit në mënyrë konstante dhe pa diferencime nga ana e këtij institucioni;

- hartimin në një kohë sa më të shkurtër të Planit Kombëtar të Caktimit të Frekuencave në fushën e transmetimeve analoge dhe numerike;

- reformimin e mëtejshëm ligjor e institucional të KKRT-së, për ta organizuar atë në mënyrë më funksionale dhe sipas të njëjtave parime që organizohen autoritetet rregullatore në të gjitha vendet europiane.

4 qershor 2007

DEKRET
Nr.5339, datë 31.5.2007

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--------------------------------------|--|
| 1. Amanda Viktor Schenkel (Topulli) | 17. Glen Aristotel Dhimgjini |
| 2. Enea Arben Goxhaj | 18. Blerinda Vehbi Hoxha (Çela) |
| 3. Tatjana Beshir Beyer (Aliu) | 19. Enkeleda Petrit Olldashi |
| 4. Klei Artur Maxhuni | 20. Ana Fatos Lubonja |
| 5. Senada Zaim Rada | 21. Hasime Safet Turka |
| 6. Orjola Xhevat Idrizi | 22. Rando Sinan Shabani |
| 7. Luljeta Skënder Nasufi (Memushaj) | 23. Renis Sinan Shabani |
| 8. Nadire Met Hidri (Tahiraj) | 24. Azem Hetem Hoxha |
| 9. Henry Astrit Hidri | 25. Endrit Gëzim Kurtaga |
| 10. Anila Sadik Zaimi | 26. Leonard Seferet Driza |
| 11. Ariana Osman Kanto (Kurti) | 28. Antonela Leon Nika |
| 12. Pranvera Shefqet Memaçi | 27. Artan Qemal Voga |
| 13. Mattias Arben Memaçi | 29. Florenca Odise Nasto (Kume) |
| 14. Sindi Arben Memaçi | 30. Aldi Mustafa Çeribashi |
| 15. Gëzim Zef Kola | 31. Sokol Nasibi Cerova |
| 16. Xhoena Hylber Dhimgjini (Qato) | 32. Mario Sokol Cerova |
| 34. Ergiselda Sokol Cerova | 33. Majlinda Ruhi Cerova (Ajdini) |
| 35. Armando Bashkim Brahja | 43. Ilirjana Refat Heringer (Rexhepaj) |
| 36. Kejsi Armando Brahja | 44. Mit-hat Jemin Schmitz (Rustaj) |
| 37. Amanda Armando Brahja | 45. Julia Mit-hat Schmitz |
| 38. Brunilda Asllan Brahja (Allmuça) | 46. Lindita Bajram Schmitz (Shahaj) |
| 39. Sjana Jahja Suchan (Vogli) | 47. Resmi Shefqet Kuka |
| 40. Claudia Faruk Duxha | 48. Schefqet Resmi Kuka |
| 41. Eduard Bashkim Gashi | 49. Albana Resmi Kuka |
| 42. Jaqueline Bashkim Gashi | 50. Marjo Resmi Kuka |
| | 51. Gentiana Bardhyl Drews (Vorpsi) |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.5343, datë 6.6.2007

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ibrahim Nuriman Abduli
2. Husamedin Qenan Selmani
3. Attila Refet Gürsel
4. Sylvie Carole Robert Ziko (Charbonné)
5. Fatime Abdulaziz Abdija (Ajdini)
6. Vlerime Hamza Krasniqi (Begolli)
7. Ard Sabajdin Krasniqi
8. Jeta Sabajdin Krasniqi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET

Nr.5350, datë 11.6.2007

**PËR KRIJIMIN E RRETHEVE GJYQËSORE, CAKTIMIN E KOMPETENCAVE
TOKËSORE DHE TË QENDRËS SË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË TYRE**

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 11 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrit të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Në territorin e Republikës së Shqipërisë krijohen 21 rrethe gjyqësore me kompetenca tokësore dhe qendra të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, si më poshtë:

1. Rrethi gjyqësor i Dibrës me qendër në Peshkopi, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Dibër e Bulqizë.
2. Rrethi gjyqësor i Sarandës me qendër në Sarandë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Sarandë e Delvinë.
3. Rrethi gjyqësor i Korçës me qendër në Korçë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Korçë, Devoll e Kolonjë.
4. Rrethi gjyqësor i Kukësit me qendër në Kukës, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Kukës e Has.
5. Rrethi gjyqësor i Beratit me qendër në Berat, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Berat, Skrapar e Kuçovë.
6. Rrethi gjyqësor i Shkodrës me qendër në Shkodër, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Shkodër e Malësi e Madhe.
7. Rrethi gjyqësor i Pukës me qendër në Pukë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Pukës.

8. Rrethi gjyqësor i Fierit me qendër në Fier, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Fier dhe Mallakastër.

9. Rrethi gjyqësor i Elbasanit me qendër në Elbasan, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Peqin.

10. Rrethi gjyqësor i Durrësit me qendër në Durrës, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Durrësit.

11. Rrethi gjyqësor i Kavajës me qendër në Kavajë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Kavajës.

12. Rrethi gjyqësor i Gjirokastrës me qendër në Gjirokastrë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Gjirokastrë, Përmet e Tepelenë.

13. Rrethi gjyqësor i Krujës me qendër në Krujë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Krujës.

14. Rrethi gjyqësor i Lezhës me qendër në Lezhë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet e Lezhës dhe Mirditës.

15. Rrethi gjyqësor i Kurbinit me qendër në Laç, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Kurbinit.

16. Rrethi gjyqësor i Lushnjës me qendër në Lushnjë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Lushnjës.

17. Rrethi gjyqësor i Matit me qendër në Burrel, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Matit.

18. Rrethi gjyqësor i Pogradecit me qendër në Pogradec, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Pogradecit.

19. Rrethi gjyqësor i Tiranës me qendër në Tiranë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Tiranës.

20. Rrethi gjyqësor i Tropojës me qendër Bajram Curri, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Tropojës.

21. Rrethi gjyqësor i Vlorës me qendër në Vlorë, i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethin e Vlorës.

Neni 2

Me hyrjen në fuqi të këtij dekreti, shfuqizohet dekreti nr.2110, datë 29.5.1998 “Për krijimin e rretheve gjyqësore, caktimin e kompetencave tokësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre”.

Neni 3

Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 4

Ky dekret hyn në fuqi më 1.9.2007.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRIË
Alfred Moisiu

DEKRET **Nr.5351, datë 11.6.2007**

PËR KRIJIMIN E SEKSIONEVE TË VEÇANTA PENALE PËR GJYKIMIN E TË MITURVE PRANË GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 13 pika 4 të Kodit të Procedurës

Penale, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Të krijohen seksionet e veçanta penale për gjykimin e të miturve, pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, si më poshtë:

1. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Tiranë, Krujë, Kurbin, Mat, Mirditë, Bulqizë dhe Dibër.

2. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Durrës, Kavajë, Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Peqin.

3. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Shkodër, Lezhë, Malësi e Madhe, Pukë, Tropojë, Kukës dhe Has.

4. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Vlorë, Fier, Mallakastër, Lushnjë, Berat, Skrapar dhe Kuçovë.

5. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Korçë, Pogradec, Kolonjë dhe Devoll.

6. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Gjirokastrë, Sarandë, Delvinë, Tepelenë dhe Përmet.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi më 1.9.2007.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRIË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.244, datë 7.3.2007

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE NË MINISTRITË DHE
INSTITUCIONET QENDRORE, PËR VITIN 2007

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve buxhetorë, për ministritë dhe institucionet qendrore, për vitin 2007, është 106 480 veta, për periudhën janar- 31 maj 2007, dhe 102 052 veta, për periudhën 1 qershor-dhjetor 2007, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA

LIDHJA NR.1	Numri i punonjësve buxhetore për vitin 2007		
Nr.	Ministria/Institucioni qendror	Janar-31 maj	1 qershor-dhjetor
3	Këshilli i Ministrave	191	192
	- Kryeministria (aparati)	124	124
	- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)	18	18
	- Agjencia e Prokurimit Publik	26	36
	- Grupi i Mbikëqyrjes	14	5
	- Komiteti Shtetëror i Minoriteteve	9	9
4	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	579	450
5	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	1 350	1 459
6	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	1 701	1 495
9	Regjistrimi i Pasurive të Paluajtshme	311	350
10	Ministria e Financave	394	424
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	44 140	43 040
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1 131	1 097
13	Ministria e Shëndetësisë	15 363	15 363
14	Ministria e Drejtësisë	2 740	3 140
15	Ministria e Punëve të Jashtme	168	168
16	Ministria e Brendshme	15 844	12 935
17	Ministria e Mbrojtjes	11 800	11 800
18	Shërbimi Informativ i Shtetit	1 079	950
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	132	140
21	Drejtoria e Rezervave të Shtetit	160	100
22	Akademia e Shkencës	500	320
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	1 375	1 415
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	1 414	1 401
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	80	82
35	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	970	970
37	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit	18	18
41	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1 516	1 200
50	Instituti i Statistikës	153	153
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	10	10
59	Instituti i Integritetit të Përndjekurve Politikë	25	25
75	Avokati i Shtetit	40	40
78	Ministria e Integritetit	66	66
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6	6
83	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave	23	22
84	Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	130	150
	TOTALI	103 409	98 981
	Institucione të pavarura	3 071	3 071
	Totali i përgjithshëm	106 480	102 052

VENDIM
Nr.316, datë 30.5.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.244, DATË 7.3.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE NË MINISTRITË DHE
INSTITUCIONET QENDRORE, PËR VITIN 2007”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.244, datë 7.3.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:
 - a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve buxhetorë, për vitin 2007, për ministrinë dhe institucionet qendrore, është 102 067 veta, për periudhën 1 qershor-dhjetor 2007, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.
 - b) Lidhja nr. 1, “Numri i punonjësve buxhetorë, për vitin 2007”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA

Lidhja

nr. 1 Numeri i punonjësve buxhetore per vitin 2007

Nr	Ministria/Institucioni qendror	Janar-31 Maj	1qershor - Dhjetor
	Keshilli Ministrave	191	195
	- Aparati	124	124
	- DSIK	18	18
	- Agjensia e Prokurimeve Publike	26	36
	- Grupi I Mbikqyrjes	14	8
	- Komiteti Shteteror i Minoriteteve	9	9
4	Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	579	450
5	Ministria e Bujqesise, Ushqimit, Mrojtjes se Konsumatorit.	1350	1459
6	Ministria e Puneve Publike, Transportit, Telekomunikacionit	1701	1495
9	Regjistrimi i Pasurive te Paluajtshme	311	350
10	Ministria e Financave	394	436
11	Ministria e Arsimit dhe Shkences	44140	43040
12	Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	1131	1097
13	Ministria e Shendetesise	15363	15363
14	Ministria e Drejtesise	2740	3140
15	Ministria e Puneve te Jashtme	168	168
16	Ministria e Brendshme	15844	12935
17	Ministria e Mbrojtjes	11800	11800
18	Sherbimi Informativ Shteteror	1079	950
20	Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	132	140
21	Drejtoria e Rezervave se Shtetit	160	100
22	Akademia e Shkences	500	320
25	Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale, Shanseve te Barabarta	1375	1415
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave	1414	1401
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	80	82
35	Drejtoria e Pergjithshme e Doganave	970	970
37	Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit	18	18
41	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve	1516	1200
50	Instituti Statistikës	153	153
57	Qendra Kombetare e Kinematografise	10	10
59	Instituti i Integritimit te Perndjekurve Politik	25	25
75	Avokati i Shtetit	40	40
78	Ministria e Integritimit	66	66
82	Keshilli Kombetar Kontabilitetit	6	6
83	Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit te Pastrimit te Parave	23	22
84	Agjensia e Kthimit dhe Kompesimit te Pronave	130	150
	Totali	103409	98996
	Institucione Pavarura	3071	3071
	Totali i Pergjithshem	106480	102067

VENDIM
Nr.326, datë 30.5.2007

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 8 e 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, në programin “Administrim, planifikim, menaxhim”, në zërin “Shpenzime kapitale, të trupëzuara”, t’i shtohet fondi prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh, për financimin e projektit “Rikonstruksioni dhe shtesa anësore e ndërtesës së selisë së Ministrisë së Shëndetësisë”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA

VENDIM
Nr.327, datë 6.6.2007

PËR LEJIMIN E DALJES JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR NË KINË, TË 22 PIKTURAVE DHE TË NJË IKONE, OBJEKTE ME VLERA UNIKALE, TË TRASHËGIMISË KULTURORE KOMBËTARE, NË DATAT 12-28 QERSHOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e ekspozimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 23 objekteve me vlera unikale, të trashëgimisë kulturore kombëtare, 22 (njëzet e dy) vepra në pikturë dhe një ikonë, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, nga Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë, Shqipëri, në Galerinë Kombëtare të Arteve, Pekin, Kinë, në datat 12-28 qershor 2007, në kuadër të çeljes së ekspozitës “Vizion & Shprehi”.

2. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr.2, datë 18.3.2004 të Këshillit të Ministrave “Për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta, kombëtare dhe unikale, për restaurimin, studimin dhe ekspozimin, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA

Lista e veprave te ekspozites "Vizion & Shprehi" qe do te organizohet ne Kine

Autori	Titulli i veprës	Teknika	Materiali	Permasa pa kornize (cm)	Numri inventarit	Pesha (kg)	Vlefte (leke)
PIKTURAT							
Abdurrahim Buza(1905-1986)	Koke femije, 1938	vaj	kompesate	29,5 x 25	12		300000
Bujar Zajmi (1939)	Portret-maske, 1968	tempera	karton	24 x 17,3	4346		150000
Foto Stamo (1916-1989)	Djaloshi jetim, 1942	vaj	kompesate	64,3 x 43,5	29		100000
Guri Madhi (1921-1988)	Portret punetori, 1961	vaj	kanavace	59 x 77	557		150000
Guri Madhi (1921-1988)	Nena Labe, 1964	vaj	kanavace	64,5 x 48,3	296		200000
Guri Madhi (1921-1988)	Koke malesori, 1955	vaj	karton	32,7 x 43,7	248		100000
Hysen Devolli (1924)	Piktori Sali Shijaku, 1982	vaj	fiber	54,7 x 69,2	3094		200000
Ilir Zefi (1963)	Portret, 1990	vaj	kanavace	67,5 x 48	4137		500000
Jakup Keraj (1932-1987)	Portret i nxeneses, 1961	vaj	karton	69,5 x 50	556		300000
Kol Idromeno(1860-1939)	Portreti i mbesës, 1930	vaj	kanavace	50 x 39,5	34		150000
Llambi Blido (1939)	Portret vajze, 1971	vaj	kanavace	43 x 52,3	1219		800000
Ndoc Martini (1880-1917)	Doktor Prela, 1913	vaj	kanavace	52,5 x 46	2		200000
Nexhmedin Zajmi(1916-1991)	Nena Labe, 1964	vaj	karton	38,5 x 49,5	100		600000
Nexhmedin Zajmi(1916-1991)	Malesorja, 1947	vaj	kanavace	39,3 x 29,5	18		300000
Sali Shijaku (1933)	Portret gruaje "Pezakja", 1975	vaj	fiber	47 x 32	2684		100000
Sali Shijaku (1933)	Nusja, 1975	vaj	fiber	48 x 41	2683		200000
Sofia Papadhimitri(1915-1976)	Portret gruaje, 1938	vaj	kanavace	50,3 x 41,5	398		250000
Theohar Gjini (1878-1952)	Skenderbeu, 1906-1910	vaj	derrase	28,5 x 23,7	836		150000
Ze Kolombi (1907-1949)	Portret gruaje te moshuar, 1937	vaj	kanavace	43 x 32	1341		100000
Zef Shoshi (1939)	Gjyshja e piktorit, 1956	vaj	thes	35,7 x 44,8	196		300000
Zef Shoshi (1939)	Portret vajze, 1965	vaj	kanavace	43,5 x 57	1527		60000
Zihni Veshi (1961)	Portret vajze, 1986	vaj	beze	71,5 x 58,5	4009		100000
Anonim IKONE	Shen Spiridoni	Kisha e Ristozit Mborje-Korçe	derrase	62 x 37 x 2,4	56		9450000

VEPRA PERSONALE **BASHKEKOHORE**

1	Albes Fusha	Pa titull, 2006	Fotografi		30 x 45	50 x 61	Personale		300 euro
2	Andi Nalibani	Ai, 2003	Vaj	kanavace	48 x 50	pa kornize	Personale		700 euro
3	Ardjan Isufi	Fragment 16, 2005	Mix media	kanavace	50,5 x 60,3	66,7 x 56,8	Personale		700 euro
4	Elsa Martini	Vajza, 1995	Vaj	fiber	33,5 x 49	50,3 x 66,2	Personale		500 euro
5	Gazmend Leka	Fytyra e shenjte, 2005	Mix	dru	48,5 x 69,8	pa kornize	Personale		1500 euro
6	Genti Korini	Fashion monkey, 2007	Miks	kanavace	59 x 60	pa kornize	Personale		700 euro
7	Najada Hamza	Autoportret, 2007	mix media	kanavace	100 x 50	(2 pjese)	Personale		700 euro
8	Orion Shima	Adami, 2000	akrilik	kanavace	60 x 70,2	pa kornize	Personale		2500 euro

Lista mbyllet me numrin rendor 31 gjithsej.

POLICË SIGURIMI MALLRA NË TRANSPORT
TRANSPORT INSURANCE CERTIFICATE

10 / 0101 / Nr. Serisë N° 001960



Nr. <u>1960</u> Datë <u>30.05.2007</u>	Kërkesa për Sigurim nr. <u>1960</u> Datë <u>30.05.2007</u> Application Form
I Siguruari (i interesuari dhe/ose i autorizuari prej tij) <i>The Insured (acting for its own account as well as for the account of whom it may concern)</i>	
<u>GALERIA KOMBETARE E ARTEVE</u> <u>TIRANE</u>	
Anija dhe/ose mjet tjetër transporti <i>Vessel and/or other means of transport</i>	
<u>AVION</u>	
Policëngarkesa <i>OB/L or Way Bill</i>	
<u>Sipas dok. bashkëngjitur</u>	
Udhëtimi prej <u>TIRANE - PEKIN</u> në <u>PEKIN - TIRANE</u> <i>Voyage from to</i> <u>Per periudhen 04.06.2007 - 10.07.2007</u>	
Përshkrimi i mallit (natyra dhe numri i paketimit) <i>Description of cargo (nature and number of packages)</i>	
<u>VEPRA ARTI</u> <u>Sipas listes bashkëngjitur</u>	
Shuma e Siguruar <i>Sum Insured</i>	Kushtet <i>Conditions</i>
<u>16 460 000 Lek</u> (GJASHTËMBËDHJETË MILION KATERQIND E GJASHTËDHJETË MIJE) LEK	<u>ALL RISKS (A)</u> Pjesa zbritshme 3% çdo dëmi e humbjeje <i>Deductible min 500 000 Lek</i>
Në rast humbjeje ose dëmi deri në destinacion, kërkesa për inspektim do të bëhet pranë: <i>In case of loss or damage at destination, application for survey to be made to:</i> <u>SIGAL sh.a.</u>	
Përveçse kur përcaktohet ndryshe, kjo Policë përbën dokumentin e vetëm origjinal. Të gjithë dëmshpërblimet për humbje ose dëme do t'i paguhën mbajtësit të Policës së Sigurimit dhe dokumentave që vërtetojnë kërkesën për dëmshpërblim. <i>Unless otherwise stated, this Certificate constitutes the sole original document.</i> <i>All indemnity for loss or damage will be paid to the holder of the original Insurance Certificate and of the substantiating claim documents.</i>	
Për sa më sipër nënshkruajnë personat e autorizuar nga Siguruesi: <i>As for above, the persons authorized by the Insurer put their signature:</i>	
 	<u>AVNI PONARI</u>

Adresa: Bul. "Zog I", Pall. Diplomatëve, Nr. 57, Tiranë, Kutia Postare 2387, Tel: 04 253407 / 04 253408; Tel.Fax: 04 250220 / 04 233308, E-mail: info@sigal.com.al.



QUESTIONNAIRE OF GOODS IN TRANSIT INSURANCE No. 1960

1 Insured GALERIA KOMBETARE E ARTEVE

2 Description of the cargo VEPRA ARTI

3 Net Weight _____ Gross Weight _____

4 No of boxes Sipas listes bashkengj Package _____

5 No. of B/L or Way Bill _____ Date _____

6 Vessel name _____ Flag _____

Does the vessel has P & I insurance Yes ☒ No ☒

Mjeti i transportit AVION

7 Truck _____ Plate number _____

8 Railway _____

9 Place of departure TIRANE - PEKIN dhe kthim Destination _____

10 Insured value 16.460.000 Lek

GJSHTEMBEDHJETE MILION E KATERQIND E GJASHTEDHJETE MIJE

11 Sum insured 16.460.000 Lek

12 Conditions of insurance ALL RISKS (A)

13 No. of L/C _____ Date _____

14 Delivering conditions _____

Filled in TIRANE on date 30.05.2007

Agent

Insured

VENDIM
Nr.31, datë 6.6.2007

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR LICENCIMIN, ORGANIZIMIN,
VEPRIMTARINË DHE MBIKËQYRJEN E ZYRAVE TË KËMBIMIT VALUTOR”**

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve dhe i rregullave për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- a) nenit 1, pika 4 shkronja “b”, nenit 12, shkronja “b”, nenit 43, shkronja “c” dhe nenit 61, shkronja “b” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- b) nenit 126 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3
Përkufizime

Për efekt të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e përdorur kanë të njëjtin kuptim si në nenin 4 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Valutë” - janë mjetet financiare në formën e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike të huaja, të cilat kanë kurs ligjor.

b) “Veprimtari e këmbimit valutor” - është veprimtaria e shitblerjes së valutave në para fizike dhe të çeqeve të udhëtarëve, ushtruar nga zyra e këmbimit valutor në emër dhe për llogari të saj, në mënyrë të vazhdueshme dhe për qëllime fitimi.

c) “Subjekt” - është personi juridik, i cili aplikon dhe licencohet, si zyrë e këmbimit valutor, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

d) “Zyra” - është ambienti në të cilin ushtrohet veprimtaria e këmbimit valutor.

e) “Të dhëna identifikuese” për një subjekt janë:

- 1. emri i tij tregtar;
- 2. numri identifikues (kodi fiskal);
- 3. adresa e selisë;
- 4. objekti i veprimtarisë së tij tregtare të përcaktuar me vendim gjykate;
- 5. emrat e kambistëve; si dhe
- 6. emri, mbiemri dhe nënshkrimi i administratorit të kësaj zyre.

f) “Faturë” - është dokumenti i lëshuar nga zyra e këmbimit valutor për çdo transaksion këmbimi, i cili përmban:

- 1. llojin e monedhës;
- 2. shumën dhe kursin e këmbimit;
- 3. vlerën e këmbyer;
- 4. komisionin;
- 5. emrin, adresën dhe kodin fiskal të zyrës; si dhe
- 6. numrin rendor të dokumentit.

g) “Bilanci në valutë” - është dokumenti në të cilin hidhen të dhënat ditore për të gjitha transaksionet e kryera, sipas informacionit të dhënë në faturë.

h) “Kurs këmbimi” - është çmimi relativ i një monedhe të shprehur në njësi të një monedhe tjetër, në një datë të caktuar.

i) “Agjent” - është personi juridik, i cili merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në

kontratën e agjencisë, sipas përcaktimeve të bëra në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

j) “Kambist” - është individ i autorizuar nga Banka e Shqipërisë për të kryer veprimtarinë e këmbimit valutor në emër dhe për llogari të zyrës së këmbimit valutor, në ambientet e zyrës.

k) “Banka” – është Banka e Shqipërisë.

Neni 4

Licencimi i veprimtarisë së këmbimit valutor

Subjekti licencohet nga Banka, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, për të ushtruar veprimtarinë e këmbimit valutor.

Neni 5

Miratimi i veprimtarisë shtesë për subjektin

Subjekti mund të kryejë pas miratimit nga Banka edhe rolin e agentit në ushtrimin e veprimtarisë financiare të transferimit të parave në emër dhe për llogari të një subjekti financiar jobankë, të licencuar nga Banka e Shqipërisë, për të ushtruar veprimtarinë financiare të transferimit të parave.

KREU II

LICENCIMI I SUBJEKTIT DHE MIRATIMI I VEPRIMTARISË SHITESË

Neni 6

Dokumentacioni për licencim

1. Kërkesa për licencim bëhet me shkrim nga administratori i subjektit ose personi i autorizuar ligjërisht prej tij dhe shoqërohet me të dhënat identifikuese, të përcaktuara në aneksin 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje, si dhe me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Vendimin e regjistrimit të subjektit si person juridik, statutin e shoqërisë, si dhe aktin e themelimit të shoqërisë tregtare, në përmbajtjen e të cilëve duhet të jetë e përcaktuar veprimtaria e këmbimeve valutore.

b) Vërtetime të lëshuara nga organet kompetente, sipas juridiksionit territorial për aksionerët ose ortakët, administratorin dhe kambistët, të cilat vërtetojnë faktet e mëposhtme juridike:

i) vërtetim se personi nuk është në ndjekje penale;

ii) vërtetim se personi nuk është në gjykim për vepra penale;

iii) vërtetim nga Ministria e Drejtësisë se personi nuk është i dënuar penalisht;

iv) vërtetim nga Zyra e Përmbërimit Gjyqësor se personi nuk ka detyrime pasurore të pashlyera.

Dokumentet e lartpërmendura duhet të jenë lëshuar jo më larg se 3 (tre) muaj nga dita e paraqitjes së aplikimit për licencë.

c) Kopje të legalizuara të dokumentit identifikues të administratorit/ve, aksionerëve ose ortakëve dhe kambistëve.

d) Dokumentin që vërteton pronësinë ose marrjen me qira të lokaleve ku do të ushtrohet veprimtaria e këmbimit valutor.

e) 2 (dy) fotografi për çdo kambist të subjektit, të cilat përdoren nga Banka për përgatitjen e kartave të identifikimit të tyre.

f) Dokumentin vërtetues mbi nivelin e arsimimit të administratorit (të paktën arsimin e mesëm).

g) Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor, për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor.

h) Vërtetim nga banka ose dega e bankës së huaj të licencuar nga Banka, që subjekti ka bllokuar shumën e kapitalit të kërkuar sipas nenit 8, pika 1 në një llogari pranë saj. Kjo shumë, zhbllokohet nëpërmjet njoftimit të Bankës, në përfundim të procedurës së licencimit.

2. Dokumentacioni sipas pikës 1 të këtij neni duhet të jetë në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të legalizuara. Ai dorëzohet në Bankë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.

Neni 7

Kërkesat në lidhje me dokumentacionin për miratimin e veprimtarisë shtesë

1. Kërkesa për miratimin e veprimtarisë shtesë në rolin e agentit, bëhet me shkrim nga administratori i subjektit të licencuar si zyrë e këmbimit valutor ose nga personi i autorizuar ligjërisht prej tij, dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Vendimi i regjistrimit në gjykatë si person juridik të zyrës së këmbimit valutor, ku të jetë e regjistruar edhe veprimtaria shtesë në rolin e agentit për transferimin e parave;

b) Kontrata e agjencisë, e lidhur ndërmjet zyrës së këmbimit valutor dhe subjektit jobankë, ku të jenë shprehur të drejtat dhe detyrimet respektive në lidhje me ushtrimin e kësaj veprimtarie;

c) Vërtetimi nga banka ose dega e bankës së huaj e licencuar nga Banka e Shqipërisë, që zyra e këmbimit valutor e licencuar ka bllokuar shumën e kapitalit të kërkuar sipas nenit 8, pika 2 në një llogari pranë saj. Kjo shumë, zhbllkohet nëpërmjet njoftimit të Bankës në përfundim të procedurës së licencimit.

2. Dokumentacioni sipas pikës 1 të këtij neni duhet të jetë në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të legalizuar. Ai dorëzohet në Bankë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.

Neni 8

Kërkesa për kapitalin

1. Kapitali fillestar minimal i kërkuar për t'u licencuar nga Banka për të kryer veprimtarinë e këmbimit valutor, është 1 500 000 lekë ose kundërvlera e tij në dollarë amerikanë (USD), ose në monedhën europiane, euro.

2. Kapitali fillestar minimal i kërkuar për të ushtruar veprimtarinë shtesë në rolin e agentit për transferimin e parave është 2 500 000 lekë ose kundërvlera e tij në dollarë amerikanë (USD), ose në monedhën europiane, euro.

3. Kapitali i përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, derdhet në një llogari bankare, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e derdhjes.

Neni 9

Shqyrtimi i kërkesës për licencim

1. Banka, në rast se konstaton që kërkesa për licencim dhe dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti nuk janë të plota në përputhje me kërkesat e nenit 6 të kësaj rregulloreje, njofton subjektin brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga marrja e këtij dokumentacioni, për nevojën e plotësimit të mëtejshëm të tij.

2. Subjekti duhet të paraqesë të dhënat dhe/ose dokumentacionin e kërkuar nga Banka dhe brenda 14 (katëmbëdhjetë) ditëve pune nga dërgimi i njoftimit, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Banka ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për licencë, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për licencim nuk plotësohet nga subjekti brenda 3 (tre) muajve pas datës së aplikimit fillestar për licencë, sipas pikës 1 të këtij neni dhe njofton subjektin për sa më sipër.

4. Pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë, sipas kërkesave të parashikuara në nenin 6 dhe në nenin 7 sipas, rastit, Banka inspekton zyrën/zyrat ku është parashikuar të zhvillohet veprimtaria e këmbimit valutor, me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve teknike dhe të sigurisë për kryerjen e kësaj veprimtarie, në zbatim të akteve nënligjore të nxjerra nga Banka për këtë qëllim. Vlerësimi i plotësimit të kushteve teknike dhe të sigurisë, kryhet nga specialistë të Departamentit të Sigurimit dhe Mbrojtjes dhe inspektorë të Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës.

Neni 10

Licenca

1. Banka jep ose refuzon dhënien e licencës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike pas plotësimit të kërkesave të parashikuara në nenin 6, nenin 7, nenin 8 dhe nenin 9 pika 4 të kësaj rregulloreje.

2. Banka, brenda 3 (tre) ditëve pune nga data e marrjes së vendimit sipas pikës 1 të këtij neni, i dorëzon subjektit licencën ose e njofton atë me shkrim mbi refuzimin e dhënies së saj, duke shpjeguar arsyet përkatëse.

3. Licenca është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patjetërsueshme.

4. Subjekti mund të ushtrojë veprimtarinë e tij në dy ose më shumë zyra, për të cilat Banka lëshon një licencë të vetme.

5. Licenca përfshin emrin tregtar të subjektit, numrin dhe datën e lëshimit të saj.

6. Licenca shoqërohet me kartën e identitetit për çdo kambist të subjektit, që autorizon kryerjen e veprimtarisë së këmbimit valutor, në emër dhe për llogari të këtij subjekti.

Neni 11

Miratimi i veprimtarisë shtesë në rolin e agentit

Banka miraton ushtrimin e veprimtarisë shtesë në rolin e agentit, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, bazuar në kërkesën e zyrës së këmbimit valutor. Në këtë rast, subjekti duhet të plotësojë kërkesat e parashikuara në nenin 7, nenin 8, pika 2, si dhe të plotësojë kushtet teknike dhe të sigurisë për kryerjen e kësaj veprimtarie, sipas nenit 9, pika 4 të kësaj rregulloreje.

Neni 12

Komisionet

Subjekti për të ushtruar veprimtarinë e këmbimit valutor, paguan në Bankë komisionet si më poshtë:

- a) për dhënien e licencës shumë prej 1 500 (një mijë e pesëqind) lekësh; dhe
- b) për çdo kartë identifikimi të kambistëve shumë prej 500 (pesëqind) lekësh.

KREU III

ORGANIZIMI DHE VEPRIMTARIA E ZYRAVE TË KËMBIMIT VALUTOR

Neni 13

Organizimi

Subjekti krijohet dhe funksionon si shoqëri tregtare në bazë të ligjit “Për shoqëritë tregtare”.

Neni 14

Veprimtaria e këmbimit valutor dhe veprimtaria shtesë në rolin e agentit

1. Veprimtaria e këmbimit valutor në zyrë ushtrohet vetëm nga kambistët e autorizuar, të cilët identifikohen nga karta përkatëse e lëshuar nga Banka.

2. Subjekti, kryen në emër dhe për llogari të vet, veprimtarinë e këmbimit valutor si më poshtë:

- a) shitjen/blerjen e valutave;
- b) shitjen/ blerjen e çeqeve të udhëtarëve.

3. Subjekti, kryen në rolin e agentit veprimtarinë e transferimit të parave, në emër dhe për llogari të subjektit jobankë nëpërmjet kambistëve të autorizuar. Në këtë rast subjekti:

- a) vendos në një vend të dukshëm për klientin, logon e subjektit financiar jobankë në emër dhe për llogari të të cilit, subjekti kryen transferimin e parave;
- b) mban në një regjistër të posaçëm, të gjitha transaksionet e transferimit të parave që ajo kryen në rolin e agentit, në emër dhe për llogari të subjektit jobankë.

c) siguron infrastrukturën e nevojshme teknike për kryerjen e veprimtarisë shtesë.

4. Subjekti ndalohet të kryejë veprimtari të tjera, përveç atyre të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 15

Kërkesat gjatë ushtrimit të veprimtarisë

1. Subjekti i licencuar për ushtrimin e veprimtarive të përcaktuara në nenin 14 të kësaj rregulloreje:

- a) organizon dhe mban kontabilitetin, në formën e përcaktuar nga ligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- b) mban libra arke për çdo monedhë;
- c) mban bilancin valutor; si dhe
- d) llogarit pozicionin e hapur nga këmbimet valutore, në fund të çdo dite.

2. Informacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ruhet sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga ligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Neni 16

Transparenca

Subjekti, gjatë ushtrimit të veprimtarive të përcaktuara në nenin 14, ruan transparencën ndaj klientit:

- a) duke afishuar në një vend të dukshëm në zyrën/zyrat e tij licencën e marrë nga Banka;
- b) duke afishuar në një vend të dukshëm në zyrën/zyrat e tij, kurset e këmbimit që përdor për veprimtarinë e këmbimit valutor;
- c) duke njoftuar në çdo rast klientin që veprimtaria e transferimit të parave ushtrohet në rolin e agjentit, në emër dhe për llogari të subjektit financiar jobankë që e autorizon, si dhe për kushtet në të cilat e ushtron këtë veprimtari;
- d) duke pajisur klientin me faturë për çdo transaksion këmbimi valutor dhe shërbimi si agjent dhe ruan një kopje të saj.

Neni 17

Parandalimi i pastrimit të parave dhe i financimit të terrorizmit

Subjekti gjatë ushtrimit të veprimtarive të përcaktuara në këtë rregullore, vepron në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit, veçanërisht në lidhje me:

- a) identifikimin e klientit;
- b) ruajtjen e të dhënave mbi klientin dhe mbi transaksionet e kryera, sipas afateve të kërkuara;
- c) raportimin pranë autoriteteve përkatëse, për transaksionet e dyshimta dhe për transaksionet, vlera e të cilave tejkalon kufirin e përcaktuar nga ligji “Për parandalimin e pastrimit të parave”.

KREU V

MBIKËQYRJA

Neni 18

Ushtrimi i mbikëqyrjes

1. Banka, realizon procesin e mbikëqyrjes së veprimtarisë së subjekteve të licencuara, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, nëpërmjet:

- a) inspektimeve në vend;
- b) mbledhjes së të dhënave financiare për veprimtaritë që ushtrojnë subjektet;
- c) zbatimit të masave ndëshkimore, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

2. Inspektimet në vend sipas pikës 1, shkronja “a” të këtij neni realizohen për të vlerësuar përputhshmërinë e veprimtarisë së ushtruar nga subjekti me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe me dispozitat e kësaj rregulloreje në fazën e licencimit, të ushtrimit të veprimtarisë deri në revokimin e licencës së saj.

Në fund të çdo inspektimi, hartohet raporti i inspektimit nga Departamenti i Mbikëqyrjes, i cili i dërgohet subjektit, së bashku me rekomandimet dhe/ose masat ndëshkimore të propozuara.

3. Mbledhja e të dhënave financiare për veprimtarinë që ushtron subjekti, organizohet sipas

nevojave të Bankës së Shqipërisë.

4. Për shkeljet e konstatuara, të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi nga subjekti, Banka zbaton masat ndëshkimore të përcaktuara në dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 19 **Raportimet**

1. Subjekti raporton pranë Departamentit të Operacioneve Monetare në Bankë për transaksionet e këmbimit valutor të kryera çdo ditë, për vëllimin e blerjeve dhe të shitjeve të valutave, si edhe për kursin mesatar të këmbimit për çdo monedhë, sipas aneksit 2 dhe aneksit 3 të kësaj rregulloreje.

2. Subjekti raporton çdo ditë në Departamentin e Operacioneve Monetare në përputhje me pikën 1 të këtij neni sipas aneksit 2 bashkëlidhur.

3. Subjekti raporton mbi baza javore, çdo të premte, vetëm pozicionet në lekë sipas aneksit 3 bashkëlidhur.

4. Subjektet, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në dy ose me shumë zyra, mbledhin informacionin nga secila prej tyre dhe raportojnë në Bankë mbi baza të konsoliduara.

5. Raportimet nga ana e subjektit në Bankë sipas këtij neni, bëhen në rrugë elektronike, me faks ose me postë.

Neni 20 **Masat ndëshkimore**

1. Banka kur konstaton se subjekti është në shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje, merr masa ndëshkimore sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

2. Banka gjobit subjektin dhe/ose administratorin e saj, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë deri në 100 000 (një qind mijë) lekë, kur konstaton se:

- a) subjekti nuk zbaton dispozitat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- b) punonjësit e subjektit nuk janë autorizuar si kambistë nga Banka;
- c) subjekti nuk afishon licencën për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor, si dhe miratimin e dhënë nga Banka lidhur me veprimtarinë shtesë të saj;
- d) kambistët e subjektit nuk lëshojnë faturën përkatëse për transaksionet e këmbimit valutor dhe të transfertave të parave në rolin e agjentit;
- e) subjekti nuk plotëson kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë lidhur me kushtet teknike dhe të sigurisë, në përputhje me aktet nënligjore të Bankës;
- f) subjekti nuk vepron në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit;
- g) subjekti nuk raporton në Bankë, në përputhje me kërkesat e nenit 19 të kësaj rregulloreje;
- h) subjekti pa dijeninë e Bankës ka ndryshuar të dhënat e tij, mbi bazën e të cilave ai është licencuar nga Banka, dhe nuk ka njoftuar Bankën e Shqipërisë për këto ndryshime.

3. Gjobat e përcaktuara sipas pikës 2 të këtij neni paguhen për llogari të Bankës.

Neni 21 **Pezullimi dhe revokimi i licencës**

1. Banka pezullon licencën e subjektit për 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike, në rast se ka prova të besueshme që subjekti është përfshirë në aktivitete të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

2. Banka revokon licencën e subjektit në rast se ky i fundit:

- a) në mënyrë të përsëritur, kryen shkeljet e parashikuara në nenin 20 pika 2 të kësaj rregulloreje;
- b) është përfshirë në aktivitete të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- c) ka paraqitur dokumentacion të falsifikuar gjatë procedurës së aplikimit për licencë ose gjatë procedurës së miratimit të veprimtarisë shtesë;
- d) ka humbur kushtet në bazë të të cilave ai është licencuar;

e) ushtron veprimtari të ndryshme nga veprimtaria për të cilën është licencuar dhe nga veprimtaria shtesë në rolin e agjentit të miratuar nga Banka;

f) nuk paguan gjobën e vendosur nga Banka sipas pikës 2 të nenit 20, të kësaj rregulloreje;

g) nuk fillon veprimtarinë brenda 45 (dyzetepesë) ditëve kalendarike nga marrja e licencës;

h) ndërpret veprimtarinë për më tepër se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike;

i) ndërpret veprimtarinë me iniciativën e tij.

3. Në rastin e revokimit të licencës, subjekti dorëzon në Bankë licencën dhe kartat identifikuese të kambistëve.

Neni 22

Procedura për vendosjen e masave ndëshkimore

1. Në çdo rast të vendosjes së masave ndëshkimore dhe të revokimit të licencës, Banka njofton subjektin, si dhe personat përgjegjës për masën ndëshkimore të dhënë dhe/ose revokimin e licencës brenda 3 (tre) ditëve pune nga data e marrjes së vendimit të saj për këto masa.

2. Banka, para nxjerrjes së aktit administrativ për marrjen e masës ndëshkimore të parashikuar në nenet 20 dhe 21 të kësaj rregulloreje, i jep subjektit ndaj të cilit propozohet vendosja e masës ndëshkimore, të drejtën për të paraqitur mendimet e tij me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve.

Neni 23

E drejta e ankimit

Subjekti ka të drejtën e ankimit ndaj çdo akti administrativ të Bankës, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në nenin 93 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 24

Detyrimi për njoftim

Subjekti gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij njofton Bankën:

a) menjëherë, kur ka ndryshime të kambistëve dhe kërkon pajisjen e kambistëve të rinj me karta identifikimi, pas dorëzimit në Bankë të kartave të identifikimit të kambistëve të larguar;

b) brenda 14 (katërbëdhjetë) ditëve kalendarike, për çdo ndryshim në të dhënat identifikuese, të përcaktuara në nenin 3, shkronja “f”, si dhe dokumentacionin e subjektit të përcaktuar në nenin 6, pika 1, shkronjat “a” deri “e” të kësaj rregulloreje.

KREU VI

Neni 25

Dispozitë kalimtare

1. Subjektet e licencuara nga Banka përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, konsiderohen të licencuara në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje. Banka ka të drejtë t’i kërkojë subjekteve të licencuara, informacione shtesë, nëse sipas opinionit të saj, informacioni i paraqitur në kohën e marrjes së licencës nuk është në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

2. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të përmbushin kriteret përkatëse për marrjen e miratimit përkatës për kryerjen e veprimtarisë shtesë në rolin e agjentit, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, brenda 6 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 26

Të fundit

1. Rregullorja “Për licencimin e zyrave të këmbimit valutor” e miratuar me vendimin nr.65, datë 30.7.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohet.

2. Rregullorja “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor” hyn në fuqi me publikimin e saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

A P L I K I M
PËR LICENCË PËR ZYRË KËMBIMI VALUTOR

1. Emri i plotë _____
(i personit juridik /shoqërisë që aplikon për licencë)

 2. Selia e shoqërisë _____
 3. Personi/personat që përfaqësojnë zyrën e këmbimit valutor sipas regjistrimit në Gjykatë.
1. _____
2. _____
etj.
 5. Emri i zyrës së këmbimit valutor _____
 6. Kodi i identifikimit në regjistrin tatimor (Kodi fiskal/NIPT-i).

 7. Llogari bankare të hapura në banka në Shqipëri.
(emri i bankës, monedha, numri i llogarisë)
1. _____
2. _____
etj.
 8. Adresa e plotë e vendit ku kërkohet të ushtrohet veprimtaria e Zyrës së Këmbimit,
1. _____
2. _____
etj.
 9. Numri i telefonit, i faksit për Zyrën e Këmbimit Valutor dhe personat e kontaktit.
1. _____
 9. Emrat e personit/ave që do të ushtrojnë veprimtarinë e këmbimit valutor.
1. _____
2. _____
etj.
- Data _____ Aplikanti _____

RAPORTIMI DITOR I VEPRIMTARISË SË KËMBIMIT VALUTOR
ZYRA E KËMBIMIT VALUTOR

	KËMBIMI I VALUTAVE KUNDREJT LEKUT				
	[1]	[2]	[3]	[4]	[5]
M ONEDHA	BLERJE	KURSI MESATAR	SHITJE	KURSI MESATAR	POZICIONI (në lekë)
EUR					[1]x[2] - [3]x[4]
USD					

GBP					
CHF					
CAD					
AUD					
...					
.					
					TOTALI I POZICIONIT (në lekë; shuma e kolonës [5])
Detajim i detyrueshëm:	Veprime me:	Blerje valutë (në lekë)	Shitje valutë (në lekë)		
	Banka				
	Zyra të këmbimit valutor				
	Biznese				
	Individë				

Shënim: Kursi mesatar i këmbimit, llogaritet si më poshtë:

$$(2) \text{ KMK}_{\text{blerje}} = (\text{VB}_1 * \text{KB}_{\text{blerje}1} + \text{VB}_2 * \text{KB}_{\text{blerje}2} + \dots + \text{VB}_n * \text{KB}_{\text{blerje}n}) / (\text{VB}_1 + \text{VB}_2 + \dots + \text{VB}_n)$$

$$(4) \text{ KMK}_{\text{shitje}} = (\text{VS}_1 * \text{KS}_{\text{shitje}1} + \text{VS}_2 * \text{KS}_{\text{shitje}2} + \dots + \text{VS}_n * \text{KS}_{\text{shitje}n}) / (\text{VS}_1 + \text{VS}_2 + \dots + \text{VS}_n)$$

- $\text{KMK}_{\text{blerje}}$ ($\text{KMK}_{\text{shitje}}$) - përcakton kursin mesatar të këmbimit për transaksionet në blerje (shitje);

VB_i (VS_i) - përcakton vlerën e transaksionit i në blerje (shitje)

- $\text{KB}_{\text{blerje}}$ ($\text{KS}_{\text{shitje}}$) - përcakton kursin e këmbimit për transaksionin në blerje (shitje).

KËMBIMI I VALUTAVE KUNDREJT VALUTAVE		
	[1]	[2]
MONEDHA	BLERJE	SHITJE
EUR		
USD		
GBP		
CHF		
CAD		
AUD		
.....		

ANEKSI 3

RAPORTIMI JAVOR* I VEPRIMTARISË SË KËMBIMIT VALUTOR ZYRA E KËMBIMIT VALUTOR

POZICIONI KUMULATIV (në lekë; nga fillimi i vitit)	Shuma progresive (në lekë) e totalit të pozicionit ditor (kolona [5] e Raportit ditor të këmbimit të valutave kundrejt lekut)
--	---

*Bëhet çdo ditë të premte

VENDIM
Nr.34, datë 8.6.2007

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR IMPORTIN E ENERGJISË ELEKTRIKE “SPAHIU GJANC” SHPK

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1 germa “dh”, dhe 15, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21 datë 4.4.2007 “Rregullorja për procedurat e licencimit” nenet 4, pika 1 germa “f”, dhe 5, pika 1 germa “f”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datë 8.6.2007, mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “Spahiu Gjanc” sh.p.k për marrje licence për aktivitetin e importit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

I. Dhënie e licencës për importin e energjisë elektrike “Spahiu Gjanc” sh.p.k. të vlefshme nga data 8.6.2007 - 7.6.2010.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.35, datë 8.6.2007

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR EKSPORTIN E ENERGJISË ELEKTRIKE “SPAHIU GJANC” SHPK

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1 germa “dh”, dhe 15, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 4.4.2007 “Rregullorja për procedurat e licencimit” nenet 4, pika 1 germa “e”, dhe 5, pika 1 germa “ë” Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.6.2007, mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “Spahiu Gjanc” sh.p.k. për marrje licence për aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

I. Dhënie e licencës për eksportin e energjisë elektrike “Spahiu Gjanc” sh.p.k. të vlefshme nga data 8.6.2007 - 7.6.2010.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

SHPLLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga rehabilitimi i rrëshqitjeve të ndodhura përgjatë segmentit rrugor Fier-Ura e Poblës.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur. Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga

plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Sqarojmë se në kolonën “Shënime” në tabelën e publikuar, pronarët për të cilët është bërë shënimi “plotësim dokumentacioni”, duhet të paraqesin dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në kuptim të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme pronë private, për interes publik”), në mënyrë që të realizohet kompensimi i tyre për efekt shpronësimi.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 11 123 523 (njëmbëdhjetë milionë e njëqind e njëzet e tre mijë e pesëqind e njëzet e tre) lekë.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MPPTT
Qarku Fier

LISTA E PRONAREVE QE PREKEN NGANDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR FIER - URA POVEL

Nr.	Emër	Atest	Mbledhja	Numri i pasurisë	Toka Bujqësore			Kulture bujqësore			Kultura drifuturore			Shënime	
					Numri i pasurisë	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi m ²	Vlera lekë	Sipërfaqja	Leke/ha	Vlera lekë	Ullinj rrenjsh	Mollë rrenjsh		Vlera totale Lekë
Rreshqitja Nr. 1															
1	Dashurie		Canaj		260	900	234000	260		1170				235170	Plotësim dokumentacioni
Rreshqitja Nr. 2															
1	Bilbil		Brahimi	5/2	93	1000	93000							93000	Plotësim dokumentacioni
Rreshqitja Nr. 3															
1	I pa identifikuar				275	700	192500	206		1030				193530	Plotësim dokumentacioni
Rreshqitja Nr. 4															
1	I pa identifikuar				1100	700	770000							770000	Plotësim dokumentacioni
Rreshqitja Nr. 5															
1	I pa identifikuar				316	400	126400	316		1106				127506	Plotësim dokumentacioni
Rreshqitja Nr. 6															
1				143/29							1		1200		
Bashkepronare															
Rreshqitje Nr. 7															
1	Sadik		Malaj	143/2	120	600	72000				3	2	5200	531400	Plotësim dokumentacioni
3	I pa identifikuar			39/14	23	600	13800							13800	Plotësim dokumentacioni
Rreshqitje Nr. 8															
1	Lefter Haxhi		Lamaj	510/40	1234	1000	1234000	1234	60000	7404				1241404	Plotësim dokumentacioni
2	Esmë Kamber		Sheme	429/1	673	900	605700	673	60000	4038				609738	Plotësim dokumentacioni
Rreshqitje Nr. 9															
1	Kujtim		Licaj	429/11	1300	900	1170000							1170000	Plotësim dokumentacioni
Shuma															
3	Dervish		Seitaj	429/25	3914	900	3522600							3522600	Plotësim dokumentacioni
4	Rexhep		Taullaj	429/28	2820	900	2538000	1075	50000	5375				2543375	Plotësim dokumentacioni
										11097000	3764	20123	6400	11123523	

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 14.6.2007
 Doli nga shtypi më 16.6.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
---------------------------	-------------------------

Shtypshkronja "Grafon"
 Tiranë, 2007

Çmimi 32 lekë